



Posta e Kosovës Sh. A.

FILATELIA E POSTËS SË KOSOVËS

RISHPALL KONKURS

Për dizajne artistike të motiveve për pulla postare dhe blloqe filatelike për programin e rregullt të pullave postare për vitin 2024

Në kuadër të programit vjetor 2024 të pullave postare, do të përzgjidhen dizajnet më të bukura për emisionin si më poshtë:

1. Tematika e emisionit: **“Evropa 2024 - flora dhe fauna nënujore në Kosovë”**.

Përshkrimi: Paraqitja artistike e florës dhe faunës në vizatim, pikturë, fotografi, grafikë.

Shpërblimi: Vendi i parë €300, vendi i dytë €250, blloku filatelik €350.

RREGULLAT E KONKURRIMIT:

1. Dizajnet artistike të bazuara në këto tema duhet të punohen në programe të specializuara për dizajn (Adobe Photoshop, Illustrator, Corel Draw, apo pamje nga piktura, fotografi, vizatime personale etj, të përpunuara grafikisht); të njëjtat duhet të dorëzohen të shtypura dhe në fajll kompjuterik.
Punimet me rezolucion më të ultë se **500 px**. (TIFF, JPG ose PDF) nuk pranohen.
2. Emri i autorit të dizajnit nuk duhet të shënohet pranë motivit konkurrues, aty duhet të duket vetëm shifra.
3. Dizajnet konkurruese për këtë konkurs duhet të dorëzohen në zarfe të mbyllura.
4. Një autor mund të konkurrojë me numër të pacaktuar të punimeve, mirëpo me shifra të ndryshme për secilin emision.
5. Punimet e printuara konkurruese me CD vendosen në zarf, i cili duhet të përmbajë edhe zarfin e mbyllur me shënimet personale të autorit.
6. Punimet konkurruese për emisione të ndryshme duhet pakëtuar veçmas, duke e shënuar mbi zarf titullin e emisionit për të cilin konkurrenca dhe shifrën.
7. Përgjegjësinë mbi të drejtat autoriale e mban autori i dizajnit (konkurruesi).
8. Bazuar në: **LIGJIN Nr. 04/L-065 PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA**, autori fitues i dizajneve të huazuara duhet patjetër të posedojë autorizimin me shkrim ose me e-mail nga autori i veprës origjinale, të cilën mund t’ia bashkëngjitë punimeve konkurruese ose ta dërgojë të skanuar në e-mail adresën: filatelia@postakosoves.com dhe ta sjellë në “hard copy” në zyrën e Filatelisë.

Për shkaqe të konfidencialitetit dhe për shkak të objektivitetit, në pjesën e jashtme të zarfeve duhet të shënohet vetëm shifra e zgjedhur nga vet autori (askund në punime nuk duhet të duket emri apo mbiemri i autorit, vetëm shifra).

Komisioni i Pullës Postare, gjatë përzgjedhjes së dizajnëve, nuk do të ketë qasje në shënime autoriale, por ka të drejtë të verifikojë mbi origjinalitetin e dizajnëve të përzgjedhur.

KONKURSI do të jetë i hapur 7 ditë kalendarike, prej datës: 21.03.2024 deri më 28.03.2024 dhe do të jetë i publikuar në ueb faqen: www.postakosoves.com.

Punimet konkurruese nuk do t'iu kthehen autorëve.

Zgjedhjen e punimeve më të mira konkurruese, duke u bazuar në dizajnin më të mirë dhe ndarjen e shpërblimeve, do ta bëjë Komisioni i Pullës Postare.

Punimet duhet dorëzuar, apo dërguar në këtë adresë:

FILATELIA

Për Konkurs-Filateli

Ndërtesa e Postës së Kosovës p.n.

Fushë Kosovë 12000

Republika e Kosovës

Për informata shtesë mund të thërrisni në numrin e telefonit: **+383(0)38 246 770**, apo të drejtoheni në e-mail adresën: filatelia@postakosoves.com, ose në ueb faqen zyrtare: www.postakosoves.com.